



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2356/Prot.

Tiranë, më 30.09.2025

VENDIM

Nr. 293, Datë 24.09.2025

**“PËR TRANSFERIMIN E PROKURORIT ENKELEDA OSMANI (XHENGO) NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, NËPËRMJET PROCEDURËS
SË LËVIZJES PARALELE”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Artë MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Valtë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olgër EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 24.09.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për transferimin e prokurorit Enkeleda Osmani (Xhengo) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2356, dt. 16.09.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pasi dëgjoi relatorin Zeqir Hoda si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë¹ është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, *“Për shpalljen e 23 (njëzet e tre) vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe shpalljen e 3 (tre) vendeve vakante nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”*, ndër të tjera, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka shpallur fillimin e procedurave për plotësimin e 23 (njëzet e tre) pozicioneve vakante nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ndër të cilat, edhe pozicioni nr. 4, në zyrën e Prokurorisë Tiranë.
3. Me Vendimin nr. 55, datë 27.03.2025, *“Për miratimin e listës së prokurorëve që kanë kandiduar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, Këshilli ka miratuar listën e prokurorëve që kanë kandiduar për transferimin nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ndër të cilët edhe kandidatët për vendin vakant si më sipër.
4. Pas miratimit të listave të kandidatëve, me Vendimin nr. 56, datë 27.03.2025, *“Për caktimin e relatorit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për kandidatët që kanë kandiduar për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, Këshilli ka hedhur shortin si dhe ka caktuar relatorët për ndjekjen e secilës prej procedurave të lëvizjes paralele. Në përfundim të procedurave përkatëse ligjore ka rezultuar se, anëtari zëvendësues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës (në vijim Komisioni), z. Zeqir Hoda është Relator për pozicionin vakant nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
5. Me e-mailin datë 30.04.2025, të Relatorit, të gjithë kandidatët janë njoftuar për caktimin e relatorit, për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tij apo të çdo anëtari të Këshillit nëse ekziston një nga shkaqet e parashikuara në Ligjin nr. 115/2016, *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar ose për çdo shkak tjetër ligjor si dhe për fillimin e verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, nga ana e Këshillit.

¹ Në vijim, Këshilli

Nga kandidatët nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e Relatorit apo anëtarit të Këshillit.

6. Me Vendimin nr. 91, datë 14.05.2025, "*Për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të kandidatëve në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, shpallur me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit*", pas verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, Këshilli ka vendosur miratimin e listës emërore të kandidatëve që kanë aplikuar në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, ndër të cilët, edhe kandidatët për pozicionin nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si dhe ndalimin e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore.
7. Kandidatët e kualifikuar që kanë kandiduar në këtë pozicion vakant kanë kaluar nga *faza e parë* që ka të bëjë me verifikimin e kushteve ligjore të kandidimit për në *fazën e dytë* të lëvizjes paralele, atë të renditjes së kandidatëve sipas kriterëve të parashikuara në nenin 43, pikat 7-9, të Ligjit për Statusin dhe në nenet 9, pika 1, germa "b", 17, pika 3 dhe 40, pika 1 të Rregullores.
8. Me Vendimin nr. 235, datë 25.07.2025, "*Për renditjen e kandidatëve të kualifikuar në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant nr. 4, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë , të shpallur me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit*", Këshilli ka vendosur:
 - I. Miratimin e renditjes së kandidatëve të cilët kanë konkurruar për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele, për pozicionin vakant Nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpallur me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, si më poshtë:
 - i. Enkeleda Osmani (Xhengo);
 - ii. Ledion Tema;
 - iii. Adnan Hoxha;
 - iv. Mediana Meta.
9. Kundër vendimit të mësipërm nuk rezultoi të jetë bërë ankim gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit.
10. Në përfundim të fazës së dytë të procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, Komisioni vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për të vijuar me *fazën e tretë*, atë të **shqyrtimit të transferimit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele të prokurorit Enkeleda Osmani (Xhengo) në pozicionin nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.**
11. Përsa i takon karrierës, prokurorja Enkelejda Osmani (Xhengo) ka përvojë si prokurore prej rreth 21 (njëzet e një) vitesh. Fillimisht është emëruar si *prokurore në stazh* në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës me Dekretin nr. 4349, datë 11.10.2004, të

Presidentit të Republikës. Më pas, me Dekretin nr. 4666, datë 03.10.2005, znj. Osmani është emëruar si *prokurore* në këtë zyrë prokurorie. Znj. Osmani është vlerësuar në aspektin etik dhe profesional në vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, me nivelin e vlerësimit “Shumë mirë”, “Mirë”, “Shumë mirë”, “Shumë mirë” dhe “Shumë mirë”.

12. Në këtë fazë përfundimtare të procesit të vendimmarrjes për transferimin e prokurorit, Komisioni mori në konsideratë çështjen e papajtueshmërisë ambientale sipas nenit 8, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, *papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë.*
13. Në rastin në fjalë, Komisioni konstatoi se ekzistojnë rrethanat e papajtueshmërisë ambientale sipas nenit 8, pika 1, më sipër, për shkak të lidhjes familjare me të afërm të kandidatës e renditur e para, znj. Osmani, pasi në këtë zyrë të prokurorisë ushtron detyrën si prokuror edhe vëllai i saj, prokurori Julian Xhengo.
14. Referuar nenit 8, pika 2, të këtij ligji, *Këshilli, gjatë transferimit të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficaenca e zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë.*
15. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është zyra e prokurorisë më të madhe në vend dhe ka një organikë prej 89 (tetëdhjetë e nëntë) prokurorë që veprojnë të organizuar sipas 5 seksioneve të ndryshme në fushat përkatëse.
16. Dispozita e mësipërme parashikon mundësinë që transferimi i prokurorit që ndodhet në kushtet e nenit 8, pika 1, të ligjit mund të realizohet nëse është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale zhvillimin e karrierës. Transferimi i znj. Osmani në zyrën e Prokurorisë Tiranë mund të bëhet duke marrë masa që prokurorja në fjalë të mos ketë raport varësie dhe hierarkie apo duke mos punuar brenda të njëjtit seksion, duke shmangur konfliktin e interesit me personin e lidhur.
17. Në dallim me këtë parashikim, neni 8, pika 4, e të njëjtit ligj ndalon në mënyrë taksative dhe pa asnjë përjashtim caktimin apo zhvillimin e karrierës së një prokurori në Prokurorinë e Posacme, i cili ndodhet në kushtet e nenit 8, pika 1, të ligjit të mësipërm.
18. Komisioni vlerëson se, kandidatja e renditur e para, znj. Osmani me përvojë të gjatë në sistem gëzon të drejtën për të zhvilluar karrierën e saj në mënyrë të natyrshme duke u transferuar në zyrën e Prokurorisë Tiranë. Ushtrimi i kësaj detyre duhet të bëhet duke

shmangur situatat e konfliktit të interesit, të përcaktuara në nenin 8, të ligjit të mësipërm.

19. Nëse Këshilli merr në dijeni kryesisht apo me kërkesë për ekzistencën e ndonjë situatë të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës nga magjistratët në fjalë, ai do të marrë masat e nevojshme administrative për rregullimin e gjendjes dhe shmangien e tij.

20. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i propozoi Këshillit, transferimin e prokurorit Enkeleda Osmani (Xhengo) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

21. Në nenin 45, pika 1, të Rregullores, parashikohet se:

“1. Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë lëvizje paralele mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori, Këshilli merr vendim për transferimin në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart.”

22. Sa i takon hyrjes në fuqi të aktit dhe krijimit të pasojave, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë dhe kalimin në detyrë në mënyrë graduale, vlerësohet zbatimi i nenit 104, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se:

“1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.

2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.

3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.

4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;

b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose

c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji.”

23. Referuar sa më sipër, pasojat juridike të aktit administrativ dhe fillimi i ushtrimit të detyrës efektive në zyrën e prokurorisë pritëse, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë, do të krijohet në një moment të dytë, konkretisht në datë 06.10.2025.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 104, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 45, të 45, të Vendimit nr. 261, datë 17.11.2020, “Për miratimin e Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Transferimin e prokurorit Enkeleda Osmani (Xhengo) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë duke filluar nga data 06.10.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurori Enkeleda Osmani (Xhengo).
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 24.09.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri



ANËTAR
Erion Fejzulla



KOPJE WEB